



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



KËSHILLI I QARKUT SHKODËR

Nr. 191 Prot

Shkodër me 15.04 2024

VENDIM

Nr. 2, Datë 09.04.2024

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË BUXHETIT TË VITIT 2023 TË KËSHILLIT TË QARKUT SHKODËR

Këshilli i Qarkut Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 09.04.2024, me propozim të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Shkodër, bazuar në nenin 40, 41, 44, 77 shkronja dh, 78, pika 3 të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", në Ligjin Nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, nenin 48 të Ligjit nr.68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes vendore", Udhëzimin nr.22, datë 30.7.2018 "Per procedurat standarte të monitorimit të buxhetit të njësisve të vetëqeverisjes vendore", Udhëzimin nr. 9 date 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", Ligjin 84/2022 "Per Buxhetin e Vitit 2023", VKQ Shkoder nr.4, datë 29.12.2022 "Mbi miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2023 dhe PBA Përfundimtare 2023-2025", Bazuar edhe në Rregulloren për Organizimin dhe Funkcionimin e Këshillit të Qarkut Shkodër, konkretisht neni 12,13, dhe 15 i saj, pas relativitetit nga zyra e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit dhe më pas diskutimit nga anëtarët e këshillit u kalua në procesin e votimit ku u Miratua me 17 Vota **Pro**, 0 Vota **Kunder** dhe 0 Vota **Abstenim**,

VENDOSI;

- Miratimin e raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit të vitit 2023 dhe tabelat e realizimit të buxhetit, pjesë përbërëse të këtij vendimi, për ;
 - Raportin e shpenzimeve sipas programeve
 - Raportin e shpenzimeve të programeve sipas artikujve
 - Projektet e investimeve me financim të brendshëm.
 - Treguesit ekonomik financiarë.
- Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Kryetari i Këshillit të Qarkut Shkodër.
- Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes së tij.

